



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:076655

Datë: 29.01.2024

Numri i dokumentit: 05250477

P.nr.1046/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.S., për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-ës, i akuzuari sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/I.nr.1582/2021 të datës 16.04.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 25.01.2024, të hapur për publikun, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Ajshe Ferati, i akuzuari A.S., përfaqësuesja e të dëmtuarës Vjollca Rexhepi Morina si dhe përkthyesi i gjykatës F. D., me datë 26.01.2024 morri e publikisht shpalli, ndërsa me datë 29.01.2024 me shkrim e përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari A.S., nga babai B., nëna S., e gjinisë F., i lindur me datë, në, me vendbanim në fshatin, Komuna e Prishtinës, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar si fasadues, i gjendjes së varfër ekonomike, serb, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 29.03.2021, rreth orës 18:44 minuta, në pyllin me të cilin qeverisë Regjioni ekonomik – pyjor Prishtina III, në vendin e quajtur “Bërnice e poshtme”, rajoni pyjor i Rimanishtës, me qëllim që me përvetësimin e sendeve të luaja të luajtshme, vetit apo personit tjetër ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i akuzuari A.S. me sharrë motorike ka prerë nëntë copë druje të llojit “Bung”, me dimensione të gjata prej 1.30 m, me vëllim të përgjithshëm 3.379m³, me ç`rast të dëmtuarës Agjencisë Pyjore të Kosovës i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 432.51 euro

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Andaj në bazë të neneve 4, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-ës të akuzuarin A. A:

E GJYKON

I. Me dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) të cilën obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

III. E dëmtuara Komuna e Prishtinës – Autoriteti Pyjor për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

IV. Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 20 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

-Rrjedha e procedurës penale-

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 22.04.2021 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1582/21, të datës 16.04.2021, kundër të akuzuarit A. S., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Me datë 28.12.2023, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ish-in prezent prokurori i shtetit Ajshe Ferati, i akuzuari A.S., përfaqësuesja e të dëmtuarës Vjollca Rexhepi Morina si dhe përkthyesi i gjykatës F. D.. Në këtë seancë prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën lëndore, me ç ‘rast i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila i vihet në barrë me ç ‘rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPRK-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të akuzuarit.

-Vlerësimi i pranimit të fajësisë-

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza, e po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

-Gjendja faktike e vërtetuar -

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale vjedhje pylli nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-ës dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj vepre penale.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse i akuzuari me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija, me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh edhe pranimin e fajit nga i akuzuari, rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihej në barrë, ka kërkuar falje për këto

veprime, është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe se pas kryerjes së kësaj vepre penale i njëjti nuk ka rënë ndesh me ligjin ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti ndonjë. Gjykata të akuzuarit ia shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

-Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike-

Duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktakuzës lëndore është cekur vlera e dëmit mirëpo lidhur me llogaritjen e këtij dëmi nuk ka ndonjë ekspertizë të veçantë por e njëjta është bërë në bazë të kalkulimit të bërë nga vet e dëmtuara gjykata konsideron se e njëjta nuk ofron bazë të mjaftueshme për gjykimin e plotë e as të pjesërishtëm të kërkesës pasurore juridike andaj edhe bazuar në nenin 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-ës, të dëmtuarën për realizimin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

-Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale-

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 1046/2021 me datë 29.01.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dibran Jusufi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Prishtinë.